

FORUMI TRANSPARENCA
DEKLARATË E THEMELIMIT

Forumi TRANSPARENCA është platformë e përbashkët veprimi e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve të Prizrenit

Misioni i Forumit është koordinimi i veprimeve të këtyre akterëve për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënieve qeverisjes lokale të Prizrenit.

Objektivat themelorë të Forumit janë: Të koordinojë dhe promovojë veprimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve që janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike, Të rrisë vizibilitetin e punës së shoqërisë civile përmes prezencës së shtuar në mediat lokale dhe qëndrore, Të ngrisë aftësinë avokuese të shoqërisë civile për qeverisje më transparente dhe llogaridhënëse në Prizren, Të ngrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurojë që kërkesat e tyre merren parasysh.

Anëtarësia e Forumit përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike. Forumi do të udhëhiqet nga një trup i përbashkët koordinues, ku do të bëjnë pjesë aktivistët dhe gazetarët e Prizrenit. Forumi do të ketë edhe Sekretariatin (stafin) e vet, që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të aktiviteteve.

Mënyra e organizimit të Forumit do të jetë joformale (i paregjistruar) dhe do të ketë vetëm një Sekretariat që do të jetë përgjegjës për organizimin e Forumit dhe implementimin e projekteve dhe aktiviteteve të tij.

Veprimet konkrete të Forumit do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në aktivitetet vijuese: avokim për miratimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë nga komuna, monitorimi i praktikave në hartimin, miratimin dhe shpenzimin e buxhetit komunal me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare, monitorimi i zbatimit të vendimeve dhe dokumenteve të miratuar nga Kuvendi i Komunës, forume publike të diskutimit mbi çështjet e qeverisjes demokratike, zhvillim i kapaciteteve dhe të tjera.

Themeluesit e Forumit janë

Nr.	ANËTARËT	ORGANIZATA / MEDIA	NËNSHKRIMI
1.	Ramadan Klisurica	Aktivist i shoqërisë civile	<i>Sh. Klisurica</i>
2.	Kreshnik Basha	Caritasi Zvicran	<i>Kreshnik Basha</i>
3.	Refet Bushati	Komuniteti i biznesit	<i>Refet Bushati</i>
4.	Qazim Thaçi	Televizioni Besa	<i>Qazim Thaçi</i>
5.	Refki Reshitaj	Radio Theranda	<i>Refki Reshitaj</i>
6.	Qazim Morina	Zëri	<i>Qazim Morina</i>
7.	Nuhi Salihu	TV Prizreni	<i>Nuhi Salihu</i>
8.	Fisnik Minci	Koha Ditore	<i>Fisnik Minci</i>
9.	Leotrim Gërmizaj	Këshilli për Veprim Rinor Lokal	<i>Leotrim Gërmizaj</i>
10.	Hajrulla Çeku	EC Ma Ndryshe	<i>Hajrulla Çeku</i>
11.	Haxhi Seferqaj	Instituti Demokratik i Kosovës	<i>Haxhi Seferqaj</i>
12.	Myrvete Axhami	Radio Televizioni i Kosovës	<i>Myrvete Axhami</i>
13.	Valbona Musliu	Radio Kosova	<i>Valbona Musliu</i>
14.	Blerim Çoçaj	Prizren Press	<i>Blerim Çoçaj</i>
15.	Shefajet Berisha	Radio Prizreni	<i>Shefajet Berisha</i>
16.	Raif Kirkul	Kosova Haber	<i>Raif Kirkul</i>

* Forumi TRANSPARENCA u themelua në muajin mars të vitit 2014